



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.03.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 1 dhe 6 mars 2019
2. Shqyrtimi dhe miratimi i programit të punës të komisionit për datat 25 mars – 12 prill 2019
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”

Marrin pjesë: Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Reme Lala, Ditmir Bushati, Xhemal Qefalia, Ilir Xhakolli, Rudina Hajdari, Ervin Bushati, Andrea Marto

Mungojnë: Evis Kushi, Elona Hoxha, Eglantina Gjermeni

Të ftuar

1. Sokol Dedja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme
2. Daniela Çekani – Drejtore për Fondet IPA
3. Iris Kruja – Përgjegjëse e Sektorit për Politikën Ekonomike

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Hapim mbledhjen e komisionit.

Sot, më 26 mars 2019, në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 1 dhe 6 mars.

Së dyti, shqyrtimin dhe miratimin e programit të punës së komisionit për periudhën 25 mars deri më 12 prill.

Së treti, projektligjin “për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet KM-së të RSH-së, Republikës së Malit të Zi Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal i Zi – Shqipëri, alokimet e viti 2017”

Të ftuar për të na folur rreth këtij projektligji kemi zotin Dedja, zëvendësministër.

Mirë se erdhët, zoti Zëvendësministër!

Zonjën Daniela Çekani dhe zonjën Iris Kruja, respektivisht drejtore për fondin IPA dhe përgjegjëse e sektorit të politikës ekonomike.

Mirë se erdhët, zonja!

Së pari, miratojmë procesverbalet e datave 1 dhe 6 mars.

A keni ndonjë vërejtje për procesverbalet?

Nëse nuk kemi konsiderohen të miratuar.

Së dyti, shqyrtimin e programit të punës së komisionit për periudhën 25 mars deri më 12 prill.

A keni ndonjë vërejtje apo sugjerim?

Nëse nuk keni e konsideroj të miratuar.

Fillojmë me projektligjin.

Zotëri, fjala për ju. Dy fjalë shkurtimisht. Është hera e tretë që vini, kështu që në mënyrë shteruese, ju lutem, dy fjalë për këtë projektligj.

Sokol Dedja – Faleminderit, zonja kryetare!

Projektligji në diskutim do të miratojë marrëveshjen e financimit, që përmban alokimet e vitit 2017 për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri.

Do të flas shumë shkurt për programin, pasi, siç thatë, është diskutuar edhe më parë.

Ky program synon zhvillimin socio-ekonomik të zonave ndërkufitare, forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve, shkëmbimin e përvojave, përmirësimin e politikave publike në zonat që, për Shqipërinë, përfshijnë qarkun e Shkodrës, qarkun e Lezhës dhe bashkinë e Tropojës.

Programimi i alokimeve financiare të këtij programi të madh 2014-2020 bëhet çdo vit mbi bazë vjetore. Sot po diskutojmë alokimin e vitit 2017, i cili është 1 milion e 400 mijë euro, nga të cilat 1 milion e 190 mijë euro janë grantet e BE-së dhe 210 mijë euro bashkëfinancimi, që do të thotë financime nga të dy vendet përfituese, Shqipëria dhe Mali i Zi.

Alokimi i vitit 2017 së bashku me alokimin e vitit paraardhës që është miratuar nga Kuvendi në vitin 2016 do të financojë thirrjen e dytë për projekte, e cila u shpall në 26 shkurt dhe është e hapur deri në 27 maj. Kemi filluar fushatën e sensibilizimit për aplikantët e mundshëm, kemi bërë lançimin në Podgoricë para një jave, do të kemi në zonat e interesuara dy sesione informuese, një më 4 prill në Shkodër dhe më 5 prill në Lezhë.

Gjatë këtyre takimeve Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme informon aplikantët e mundshëm, aktorët e interesuar, shoqatat, bashkitë në zonat e interesuara lidhur me procesin e aplikimit, kushtet që duhet të plotësohen dhe do të jetë vazhdimisht në dispozicion të aplikuesve për sqarime, për plotësime të aplikimeve të tyre deri më 27 maj kur mbyllet kjo thirrje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Përpara se të kalojmë në pyetje dhe diskutime, nëse nuk gaboju, herën e fundit që kemi diskutuar për këtë marrëveshje financiare, ne si komision kemi kërkuar një informacion më të zgjeruar lidhur me mbarëvajtjen procesit deri tani, kështu që do të kisha dashur miqësisht që të mund të sillni një raport, jo domosdoshmërisht të detajuar, por të përmbledhur lidhur me çka është bërë deri tani, si ka ecur procesi dhe si mendoni që në fund të këtij projekt, kësaj marrëveshjeje, do të mund të kemi rezultatet e kërkuar, cilët janë përfituesit e kështu me radhë.

A ka pyetje ose diskutime?

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Në fakt, duke lexuar marrëveshjen, ju e thatë edhe në fjalën tuaj që vlera prej 210 milionësh u takon të dyja palëve.

Sa janë të palës shqiptare dhe sa janë të palës malazeze?

E dyta, ju i keni përmendur 3 rrethet që përfitojnë nga ky alokim fondesh. Bëhet fjalë për Tropojën, Lezhën dhe Shkodrën, ndërkohë që për Malin e Zi janë një sërë qytetesh, zonash. Është pasur në konsideratë numri i popullsisë apo sipërfaqja territoriale?

Faleminderit!

Sokol Dedja - Faleminderit!

Lidhur me pyetjen e parë po sqaroj se bashkëfinancimi del nga buxheti i përfituesve, pra duhet të mbarojë procesi i përzgjedhjes së projekteve, do të zgjidhen përfituesit dhe aty do të shihet se sa do të financojë OJF-të që do të përfitojnë, bashkitë që do të përfitojnë do të varet nga projektet. Pra, ky përfundim nxirret pas përzgjedhjes së projekteve.

Për sa u përket zonave të mbuluara, synimi është që popullsia të jetë pothuajse e njëjtë në të dy anët e kufirit, prandaj është më e madhe në Mal të Zi, sepse popullsia atje është më e vogël, pra numri i popullsisë është thujse i njëjtë në të dy anët e kufirit.

Mimi Kodheli – Urdhëroni, ministri Bushati!

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, doja të vlerësoja prezantimin e ministrisë për këtë projektligj. Duke qenë se para pak muajsh kemi pasur një diskutim në komision, por kemi qenë në anë të ndryshme të tryezës, mund t'ju them që jemi pak a shumë në të njëjtën situatë, pra, kur kemi të bëjmë me një procedurë klasike të kalimit të marrëveshjeve dhe cikleve buxhetore për sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshjeje nga ana e Komisionit European me vendet që janë palë e marrëveshjes dhe nuk se ka ndonjë hapësirë për vlerësim nga ana jonë për sa i përket miratimit të kësaj marrëveshjeje

Besoj se jemi të gjithë në favor të miratimit të marrëveshjes.

Nga ana tjetër, besoj se nga puna që është nisur nga ministria me ditët e informimit nëpër qarqe apo nëpër zonat që preken nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe që ofrojmë mundësi për institucionet vendore apo për organizmat e shoqërisë civile, ne, ndoshta mund të kemi një informacion më sistematik për impaktin e zbatimit të këtyre marrëveshjeve, sepse përgjithësisht diskutimet janë mbi mënyrën se sa alokohen për një vend apo për një vend tjetër, ndërkohë që është e rëndësishme për të pasur edhe një vlerësim sa më qartë rreth impaktit, fuqizimit të kapaciteteve vendore apo atyre të shoqërisë civile, binjakëzimeve të ndryshme që do të duhet të fillojnë dhe të stimulohen edhe për shkak të mundësisë që Shqipëria ka për të aplikuar për projekte të ndryshme. Por besoj se thelbi kryesor i këtyre programeve nuk ka shumë lidhje me kontributin e Shqipërisë, sepse kontributi i Shqipërisë dhe i Malit të Zi si vende përfituese është më modest krahasuar me ndihmën që vjen nga ana e Komisionit European, pra nga taksapaguesit europianë.

Besoj se fokusi kryesor, si një sugjerim kësaj radhe për qeverinë, do të duhet të jetë te fuqizimi i kapaciteteve në mënyrë kapilare dhe nevoja për të pasur një dokument mbi impaktin që kanë pasur këto projekte apo që kanë këto projekte.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, ministri Bushati!

Di që zëvendësministri ka një impenjim tjetër, kështu që, zoti Dedja, jeni i lutur dhe i lejuar të largoheni.

Faleminderit për prezencën tuaj!

A ka diskutime të tjera?

Nëse nuk kemi asnjë pyetje apo diskutim, mendoj ta kalojmë në votim.

Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi – Shqipëri, alokimet e vitit 2017”?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kur mund a sillni materialin të cilin e kërkuam, zonja drejtoreshë?

Daniela Çekani – Aktualisht ne jemi angazhuar në një proces konsultimi me autoritetin kontraktor, delegacionin e BE-së për sa i përket perspektivës financiare 2007-2013 dhe kemi marrë të dhënat e para, ndërkohë po punojmë edhe me të dhëna të tjera për perspektivën financiare 2014-2020.

Nuk di se kur ju e dëshironi këtë material, pasi ne e kemi një draft të parë të tij. Sa i takon impaktit duhet të përmend se do të bëhet i mundur ndoshta më vonë nga shërbime ekspertize të vetë KE-së sepse zbatimi i projekteve nuk ka përfunduar ende.

Mimi Kodheli – Po një parashikim e keni besoj.

Daniela Çekani – Kemi një draft të parë me të dhëna për periudhën e parë. Do t’ju sjellim atë që disponojmë për momentin, me shpjegimet përkatëse, për hapat që do të marrim në vijim.

Mimi Kodheli – a jeni dakord për në mesin e muajit prill?

Daniela Çekani – Dakord.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Punë të mbarë!

E mbyllim mbledhjen e komisionit për sot.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni.

MBYLLET MBLEDHJA